



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 06.08.2025

Numër Protokolli: 5445/2025

A.nr.1022/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1022/2025, të datës 29.05.2025, të parashtruar nga ankuesja L.K-B, kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil, në çështjen juridike *‘transferim si pasojë e ristrukturimit’*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 06.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1022/2025, të datës 29.05.2025, të parashtruar nga ankuesja L.K-B.

A r s y e t i m

Ankuesja L.K-B (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja), me datë 30.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.AAC/003-2025, të datës 30.04.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimit i provave të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankueses, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil, mbanë pozitën *Drejtori i Departamentit për Siguri dhe Cilësi*

Tutje nga shkresat e lëndës rrjedhë së Kryeministri i Republikës së Kosovës ka miratuar Rregulloren (AAC) Nr. 02/2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin e Aviacionit Civil. Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 09.03.2025 ka nxjerr Vendimin nr. 228/2025 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit në Autoritetin e Aviacionit Civil, ndërsa, ky i fundit, më datë 18.04.2025, ka përgatit raportin e punës me numër protokolli 859, duke propozuar që ankuesja të sistemohet në pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Siguri dhe Cilësi*. Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më Vendimin Nr. AAC/003/2025, të datës 30.04.2025,

ka transferuar ankuesen nga pozita aktuale Drejtori i Departamentit për Siguri dhe Cilësi në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Siguri dhe Cilësi në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr.AAC/003-2025, të datës 30.04.2025, të Drejtorit të DMZP-së, pretendon në rastin e saj vendimi i kontestuar është marr në kundërshtim me dispozitat ligjore ngase më është mohuar e drejta e njoftimit. Jam ulur në pozita nga pozita e kategorisë së mesëm në pozitë të kategorisë së ulët drejtueses në kundërshtim të plotë më legjislacionin përkatës, kështu që, është dëmtuar në klasë dhe pagë. Tutje, ankuesja shton së raporti i ristrukturimit është i paqartë, sepse pozita e saj Udhëheqës i Divizionit për Siguri dhe Cilësi a konsiderohet Ekspert 2 apo 3. Ky raport nuk është miratuar nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe se rregullorja e brendshme e AAC-së është kontestuar në Gjykatën Supreme të Kosovës. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet vendimi i kontestuar.

Në procedurë të shqyrtimit të ankesës, Këshilli ka pranuar më datë 04.08.2025, njoftimin e Drejtorit të DMZP-së, si organ që ka nxjerr vendimin e kundërshtuar me ankesë, duke njoftuar se me pranimin e Aktgjykimit P.A.nr.07/2025, të Gjykatës Supreme, ka shfuqizuar të gjitha vendimet e ristrukturimit të AAC-së të nxjerra nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me arsyetimin se transferimi i nëpunësve të AAC-së është bërë duke u bazuar në pozitat e përcaktuara sipas Rregullores (AAC) Nr. 01/2025, rregullore kjo e shfuqizuar nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit P.A.nr.07/2025. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethana, rrjedhimisht duke qenë se akti i kontestuar Vendimi me Nr.AAC/003-2025 i datës 30.04.2025 është shfuqizuar sipas Vendimit me Nr. AAC/027/2025 të datës 04.08.2025 nga Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kolegji erdhi në përfundim së objekti i ankesës është bërë i pamundur/kotë, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku parashihet: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot, si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1022/2025, të datës 29.05.2025.*

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1022/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses L.K-B;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë /MPB;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil;
- Arkivit të KPMSHCK-së.